


TaxNews

December 2020
Dhjetor 2020



I. Ndryshime në ligjin për sistemin e taksave vendore

Duke filluar nga data 1.1.2021, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin reduktohet në 0% për bizneset e vogla me qarkullim 0 deri në 8 milionë lekë (deri më 31.12.2020 shkalla tatimore ishte 0% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor 0 deri në 5 milionë lekë dhe 5% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor 5 deri në 8 milionë lekë). Për rrjedhojë, me efekt nga 1.1.2021, shfuqizohet edhe detyrimi i bizneseve të vogla për parapagim të kësteve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

Këto ndryshime janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 12.11.2020 nëpërmjet ligjit nr. 122/2020, datë 15.10.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar".

II. Shtesë në ligjin për TVSH

Duke filluar nga data 1.1.2021, shkalla e TVSH-së për shërbimet e punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve/federatave sportive dhe investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive do të reduktohet në 6%.

Ky ndryshim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 197, datë 12.11.2020 nëpërmjet ligjit nr. 123, datë 15.10.2020, "Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

I. Amendments to the law on the local taxes system

Starting from 1.1.2021, the tax rate for the simplified corporate income tax is reduced to 0% for small businesses with annual turnover ALL 0 to ALL 8 million (*until 31.12.2020, the tax rate was 0% for taxpayers with annual turnover from ALL 0 to ALL 5 million and 5% for taxpayers with annual turnover from ALL 5 to ALL 8 million*). Consequently, with effect from 1.1.2021, the obligation of small businesses to prepay the simplified corporate income tax installments is abrogated.

These amendments are published in the Official Gazette no. 197, dated 12.11.2020, through law no. 122/2020, dated 15.10.2020, "On some additions and amendments to the law no. 9632, dated 30.10.2006, "On the local taxes system", as amended".

II. Addition to the law on VAT

Starting from 1.1.2021, the VAT rate for construction work services for state investments in sports clubs / federations, and investments of private entities in sports infrastructure, will be reduced at 6%.

This amendment is published in the Official Gazette no. 197, dated 12.11.2020 through law no. 123, dated 15.10.2020, "On an addition to the law no. 92/2014, "On value added tax in the Republic of Albania", as amended".

III. Ndryshimi i pagës minimale në shkallë vendi

Duke filluar nga muaji janar 2021, paga minimale mujore në shkallë vendi do të jetë 30,000 Lekë (*më parë e barabartë me 26,000 Lekë/muaj*). Kjo pagë i korrespondon orëve normale të punës prej 174 orë/muaj. Rrjedhimisht, paga minimale orare në shkallë vendi është përcaktuar në 172.4 Lekë/orë (*më parë e barabartë me 149 Lekë/orë*).

Paga minimale në shkallë vendi prej 30,000 Lekë do të shërbejë gjithashtu edhe si kufi i poshtëm për llogaritjen e kontributeve të sigurimit shoqëror e shëndetësor duke filluar nga muaji janar 2021.

Njëkohësisht, edhe paga maksimale për qëllime të përlogaritjes së kontributeve të sigurimit shoqëror do të rritet duke u indeksuar në të njëjtën masë.

Ndryshimi i pagës minimale mujore në shkallë vendi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 223, datë 21.12.2020 me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", i cili shfuqizon VKM-në e mëparshme nr. 809, të datës 26.12.2018.

IV. Disa shtesa dhe ndryshime në VKM për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kriterëve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit

Platforma qendrore e faturave do të mund të përdoret për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, në vend të zgjidhjeve software-ike të certifikuara nga:

III. Amendment of the minimum salary on national level

Starting from January 2021, the minimum monthly salary on the national level will be ALL 30,000 (*previously equal to ALL 26,000/month*). This salary corresponds to normal working hours of 174 hours/month. Consequently, the minimum hourly salary on national level is set at ALL 172.4/hour (*previously equal to ALL 149/hour*).

The minimum salary on national level of ALL 30,000 will also serve as the lower limit for the calculation of social and health insurance contributions starting from January 2021.

Simultaneously, the maximum salary for the purposes of calculating social security contributions will be increased by being indexed by the same rate.

The amendment of the minimum monthly salary on national level is published in the Official Gazette no. 223, dated 21.12.2020 through the Decision of the Council of Ministers no. 1025, dated 16.12.2020 "On determining the minimum salary on national level", which repeals the previous DCM no. 809, dated 26.12.2018.

IV. Some additions and amendments to the DCM on determining the category of taxpayers and the criteria for using the simplified fiscalization procedure

The central invoicing platform may be used for issuing and fiscalizing invoices, instead of certified software solutions by:

1.Tatimpaguesit që përmbushin njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a.** Nuk janë subjekt i TVSH-së;
- b.** Janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
- c.** Kanë vetëm një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- d.** Kanë statusin ligjor "Person fizik" dhe kategorinë e punësimit "I vetëpunësuar i vetëm".

2.Tatimpaguesit që kryejnë transaksione pa para në dorë me organet publike (*për të cilët ka filluar zbatimin e fiskalizimit që nga data 1.1.2021*), por deri në datën 30.6.2021 (*pra, nga data 1.7.2020 e më tej do duhet ta vijojnë procedurën e fiskalizimit me anë të zgjidhjeve software-ike të certifikuara*).

3.Organet publike qendrore dhe vendore.

Këto ndryshime janë publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 233, datë 30.12.2020, nëpërmjet VKM nr. 1091, datë 24.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 220, datë 12.03.2020, "Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kritereve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit", të ndryshuar".

1.Taxpayers who simultaneously meet all of the following conditions:

- a.** are not subject to VAT;
- b.** are subject to simplified corporate income tax for small business;
- c.** have only one place of business activity;
- d.** have the legal status "Natural person" and the employment category "Sole self-employed".

2.Taxpayers who carry out cashless transactions with public bodies (*for whom the implementation of fiscalization has started from 1.1.2021*), but until 30.06.2021 (*i.e. from 1.7.2021 onwards will have to follow the fiscalization procedure through certified software solutions*).

3. Central and local public bodies.

These amendments are published in the Official Gazette no. 233, dated 30.12.2020, through DCM no. 1091, dated 24.12.2020 "On some additions and amendments to the DCM no. 220, dated 12.03.2020, "On determining the category of taxpayers and the criteria for using the simplified fiscalization procedure", as amended".

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.